

Kuvendet kombetare dhe Roli i tyre në Pajtimin e gjaqeve

Haki Kabashi

h_kabashi@yahoo.com

Abstrakt

Vrasja është njëri ndër krimet më të rënda kundër të cilit soqëria njerëzore ka reaguar në forma të ndryshme dhe të cilat forma të reagimit janëparaprë në monumentet me të hershme juridike të vendeve të ndryshme. Në këtë kuadër, vrasja nga hakmarrja dhe gjakmarrja zë vend të rendësishëm në jetën dhe traditën tonë edhpse kjo formë e reagimit është jo një mungësë e kulturës apo një reagim barbar por është një reagim i cili në mungesë të shtetit dhe institucioneve të tij kishte për bazë mbrojtjen e ekzistencës dhe jetës së njeriut. Shikuar historikisht, në krijimin dhe formimin e shtetit shqiptar, hakmarrja dhe gjakmarrja kanë qenë pengesa të cilat kanë penguar unifikimin e faktorit shqiptar në luftëpër liri dhe pavarësi. Për eliminimin e kësaj pengese, në vite, që nga Kuvendi i Lezhës e kendej, prijës të ndryshëm nga krahina të ndryshme të viseve të Ilirisë së dikurshme i kanë kushtuar rendësi luftimit të kësaj dukurie me qëllim unifikimin kombëtar për çlirim, liri dhe pavarësi. Fatëkeqësisht, liderët shqiptar, kanë qenë të detyruar të shpenzojnë mjaft energji për unifikimin e luftës kundër anmiqëve të ndryshëm dhe kundër dukurisë së hakmarrjes dhe gjakëmarrjes e cila ishte një plagë që kullonte gjak në rrugëtimin biblik të kombit shqiptar i cili edhe me Pavarsinë e Kosovës me 17 shkurt 2008 ende nuk është zgjidhur plotësisht. Gjatë këtij rrugëtimi historic, shqiptarët janë të njohur me me vendimet e tyre plebiscitare të nxjerrur në Kuvende kombëtare të cilët kishin dy qëllime:eliminimin e hakëmarrjes dhe gjakëmarrjes mes tyre dhe unifikimin kombëtar në luftë për liri dhe pavarësi. Të tilla Kuvende, janë mbajtur gjatë tërë kohës së pushtimit turk dhe serb deri në vitin 1990.

Fjalë kyqe: Kuvendi, vrasjet, hakmarrja, Verrat e Llukës, Kosova.

Hyrje

Rënja e viseve shqipëtare nën pushtimin turk, ka ndikuar në forcimin e mënyrës së jetesës autonome të shqipëtarëve në bazë të traditës dhe të drejtës zakonore shqiptare e cila bazohej në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Kanunin e Skënderbeut dhe në Kanunin e Labërisë në Jug. Per nje çerek shekulli, shqiptarët

ishin mbedhur rreth Skenderbeut dhe shtetit të tyre i cili pas 25 vjetësh ekzistence, ripushtohet nga turqit për t'u rishpall në gjysmën e trungut të tij me 28 nëntor 1912 ku gjysma e saj, Kosova mbetet nën pushtimin e Sërbisë. Gjatë tërë kësaj periudhe kohore, në mungesë të një organizimi shtetëror dhe nën pushtimin e huaj turk dhe serb, shqiptarët jetuan duke u bazuar në doket dhe traditat e tyre të cilat jo rrallë edhe kanë sjell plagë të rënda në trupin e tyre. Ndër plagët e rënda që i kishin pllakosur shqiptarët e qe konkuronin terrorin e pushtuesit të huaj ishte hakmarrja dhe gjakmarrja. Me qëllim të tejkalimit të kesaj situate, shpesh herë udhëheqësit e krahinave të ndryshme të Shqipërisë organizonin tubime, kuvende ku kërkohej një bashkërendim dhe bashkëveprim kundër pushtuesve e cila paraprihej me një kërkesë për lënje anash të hasmërive mes tyre. Historia shqiptare njeh iniciativa të tilla ku tribun të ndryshem, udhëheqës popullor, kërkonin nëpër kuvende, që të lenin anash hakmarrjen dhe të bashkoheshin për mbrojtjen e ekzistencës kombëtare. Kuvendi i parë ku u kërkuar një bashkërendim i mirëfilltë pajtimi mes shqiptarëve daton nga koha e Gjergj Kastriotit që njihet si **Beslidhja e Lezhës e janarit 1444. Në këtë Kuvend, mes tjerash**, ishte kërkuar eliminimi i të gjitha hasmërive dhe bashkimi i të gjithë princërve shqiptar nën një flamur dhe për një atdhe dhe përfundon me kuvendet e mëdha mbarëkombëtare në Kosovë në vitin 1990.

Roli i Kuvendeve kombëtare në luftimin e hakmarrjes dhe gjakmarrjes dhe unifikimin kombëtar

Ngatrrerat mbrenda kombit kishin dobësuar fuqinë politike, ushtarake dhe ekonomike të vendit, dhe mu për këtë kërkohej që të ndaleshin hasmëritë dhe të luftohej për mbrojtjen e vendit dhe të lirisë. Ky pajtim kërkohej me qëllim që të eliminohej gjakderdhja mbrenda llojit dhe kundërvenja e përbashkët kundër armikut që kërkonte zhdukjen e llojit duke ndihmuar dhe nxitur në forma të ndryshme fenomenin e hakmarrjes dhe gjakmarrjes. Edhe pse „Gjakmarrja ishte një institucion tipik i të gjithë popujve pak të qytetruar”¹²⁴ (si një fenomen që dikur kishte efekt mbrojtës) për shqiptarët ishte dhe është një ogur i zi me pasoja të paparashikueshme.

Pushtimet e huaja dhe mungesa e një organizimi të mirëfilltë shtetëror në viset e banuara me shqipëtar ka ndikuar që tradita dhe normat e së drejtës zakonore të jenë një rregullator i jetës shoqërore duke treguar edhe një supremaci ndaj të drejtës shtetërore të pushteteve të huaja që kanë sunduar në këto troje. Përkundër një supremacie ndaj të drejtës shtetërore, në periudha të caktuara kohore, e drejta

¹²⁴ Vilari, Salvatore Normat Zakonore Juridike te Shqipërisë, Kanuni i Lekë Dukagjinit Romë 1940, OMBRA GVG 2012 fq. 177)

=====

zakonore jo gjithëherë ka arritur të vendosë paqe e siguri sidomos në eleminimin e hakmarrjes dhe gjakmarrjes, sepse ky institut i së drejtës zakonore ishte një e drejtë dhe obligim jo vetëm i anëtarëve të familjes por edhe i fisit. Përpjekjet për ndryshimin dhe riorganizimin e drejtësisë sipas të drejtës zakonore dhe eleminimin e dukurisë së hakmarrjes në Shqipërinë e Veriut datojnë që nga vitet 1844, 1857, 1863, 1898, 1905, 1908).

Në këto kuvende ishte kërkuar kufizimi i hakmarrjes dhe gjakmarrjes ose edhe ndalimi i saj nga krere fisesh të krahinave të ndryshme të trojeve shqiptare nga katër Vilajetet. Si rezultat i këtyre iniciativave, ishin rikrijuar rregulla mbi kufizimin e të drejtës së gjakmarrjes, garantimi i lëvizjes së lirë të çobanit dhe bagëtisë, vrasjen e atëvrasësit nga fisi, paprekshmerinë e femrës dhe fëmijëve, amnestia e deri tek syrgjynosja e atyre që thejnë këto vendime¹²⁵.

Përpjekje të tilla kundër dukurisë së gjakmarrjes janë regjistruar në zonat e jugut të Shqipërisë ku njerëz me autoritet nga këto zona të cilat kërkesa artikulohehin nëpër kuvende popullore. Eshtë mjaft interesant se mbajtja e këtyre kuvendeve dhe thirrja për pajtim korrespondonin gjithmonë me dhunën që pushtues të ndryshëm ndërmerrnin në këto troje. Sipas të dhënave që posedojmë del se një kuvend i tillë ku ngatrrsat, belatë, vrasjet nga hakmarrja dhe gjakmarrja ishin parashtruar krahas kërkesave politike dhe kundërshtive për Reformat e Tanzimatit të vitit 1839. Në këtë vit në Progonat të Kurveleshit në vendin e quajtur „**Lisat e Kadhe**” ishte organizuar **Besëlidhja e popullatës së kësaj ane** e udhëhequr nga tribuni popullor Zenel Gjoleka me prijës të tjerë të Krahinave të Jugut të Shqipërisë. Në këtë kuvend përveq tjerash ishte kërkuar „ t’i shmangeshin dhunës e hakmarrjes” me qëllim të organizimit „...më të mirë të kryengritjes kundër reformave të Tanzimatit”.

Në pjesën e dytë të vitit 1847, ishte mbajtur edhe një Kuvend në Poçëm të Mallakastrës e cila udhëhiqej nga një figureë tjetër madhore kombëtare Rrapo Hekali. Ky tribun popullor duke i parë interesat e kombit mbi interesat e veta dhe duke e parë se gjakmarrja ishte një fenomen që dobëson forcën kundër armikut të përbashkët, vepron me urtesë dhe burrëri duke ia fal gjakun e babait të tij , bashkefshatarit Mano Hoxhaj. Veprimet e tilla të njerzve me autoritet kishin efekt në respektimin e vendimeve që merreshin asokohe në kuvende të tilla dhe mobilizonin krahina të tëra kundër pushtuesit të huaj.

Në anën tjetër të atdheut, në Kosovë, pikërisht në Drenicë ishte organizuar një kuvend i cili njihet si Besa e Morinës (viti 1864) në ballë të të cilit ishte tribune popullor Ahmet Delia i Prekazit. Në këtë kuvend ishte dhënë Besa për ndërprerjen e armiqësive dhe bashkimin e armëve kundër Turgut Pashës i cili kishte mësyë me

¹²⁵ (Vilari, Salvatore Normat zakonore juridike të shqiperise, Kanuni i Lek Dukagjinit, fq 180-194)

=====

ushtri këtë pjesë të trungut Ilir.¹²⁶

Më pas, vjen Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit (10 qershor 1878) ku ishte vendosur një Besë e përgjithshme dhe kërkohej përveq kërkesave politike, të ndaloheshin vrasjet nga gjakmarrja për shkak se viset shqiptare ishin shëndrruar në objekt diskutimi në Kongresin e Berlinit për të kënaqur apetitet e shteteve ballkanike.¹²⁷

Pas Kuvendit të Lidhjes së Pnë Pejë organizohet Kuvendi „Besa Besë” e udhëhequr nga Haxhi Zekë Biberi nga Peja ku merrnin pjesë prijës popullor ngatë gjitha trevat shqiptare. Në këtë kuvend i cili është mbajtur në Pejë me datën 26-30 janar 1899, ishte nxjerrje një rezolutë mes të cilave në pikën 4 kërkohej: „ Ndalohet hakmarrja deri në Shën Mitër, dmth deri me 7 nandor 1899” dhe nëse dikush e thyen këtë kërkesë, denohej sipas nenit 7 I cili thoshte: „Nëse ndokush mbrenda kësaj kohe e vret dikend, do t’i digjet shtëpia”. Masa të ashpra ishin paraparë edhe për ata që do kryenin ndonjë dhunë fizike e cila ishte paraparë në pikën 8 ku thuhej „Të njejtat rregulla vlejné edhe për ndeshkime fizike”¹²⁸.

Meqenëse viset shqiptare ishin shëndrruar në fushë eksperimentimi nga pushtuesit të ndrsyhëm dhe ndihmaqarët e tyre, në fillim të shekullit të XVIII, nën drejtimin e Idriz Sulit nga Zhulati, mbahet Kuvendi i Dytë në vendin e quajtur „Rapi i Agait” në Zhulat. Nën iniciativën e tij fillon një reformism i Kanunit të priftit Papa Zhuli i cili do të quhej Kanuni i Labërisë. Në këtë Kuvend ishte kërkuar respektimi i vendimeve të pleqësisë, zgjidhja e konflikteve përmes bisedimeve, zgjidhja e problemeve rast pas rasti, forcimi i të drejtës së pronës private, kufizimi i hakmarrjes, mbrojtja gruas dhe vajzave, ndalimi i vrasjes së fëmijëve për hakmarrje, plakut, gruas, hasmit në prezencën e gruas, ndalimi i hakmarrjes në rast të fatkeqësive natyrore, në rast të luftës, e drejta e shkurorëzimit dhe gjoba ishte paraparë si masë ndëshkimi etj.¹²⁹

Me 6 shkurt 1903 u mbajt një Kuvend në fshatin Isnig të Deçanit pas të cilit pasojnë Kuvendi i 26 marsit 1903 ne fushen e Marinës në fshatin LLaushëete Drenicës, Kuvendi te Verrat e Llukës së Eperme të Deçanit i datës 11 prillit 1903, Kuvendi i Pejes i dates 1 maj 1903, për tu kthyer prap ne Lluke te Eperme të Deçanit në prill të vitit 1910. Mbajtja e të gjitha këtyre kuvendeve anë e kend trojeve shqiptare kishte dy qellime kryesore: unitetin e brendshëm, paqëtimin e zemrave brenda kombit shqiptar, eliminin e hakmarrjes dhe krijimin e një fronti të

¹²⁶ Hoti, Behram Moti i madh i Kosoves 1990 Pajtimi i gjaqeve, Faik Konica, Prishtinë 2012 fq. 165)

¹²⁷ Historia e Popullit Shqiptar II, ASHSH, Instituti i Historisë, Toena Tiranë 2002, fq. 155)

¹²⁸ Rrahimi, Shukri Vilajeti i Kosoves me 1878-1912, Enti I teksteve dhe mjeteve të KSAK Prishtinë, 1969, fq. 96)

¹²⁹ Elezi Ismet Kanuni i Laberise, Toena, Tiranë 2006, fq. 211-230).

=====

përbashkët ushtarak kundër armiqëve që kishin për qëllim shtypjen dhe zhbërjen e kombit, kulturës dhe traditës shqipëtare. Në këtë frymë vlen të përmendet përpjekja e Komitetit „Mbrojtja Kombëtare e Kosoves” e udhëhequr nga Hoxhë Kadri Prishtina, dhe tubimet tjera në mbajtura gjatë kësaj kohe në Krahina të ndryshme të Shqipërisë se Mesme dhe të Veriut ku qëllim kryesor ishte unifikimi në aspektin politik dhe mobilizimi që ta sfidonin „...zakonin e gjakmarrjes, si plagë e rendë shoqërore e së kaluarës duke u bashkuar si një trup i vetëm për t’u dalë zot fateve të atdheut të coptuar e të pushtuar”.¹³⁰

Kuvendet Kombetare pas periudhës së Pavarësisë së Shqipërisë

Në favor të kufizimit të së drejtës së vetgjqësisë rendësi të madhe pati miratimi i „Kanunit të Zhurisë”, një gjysmë ligj e gjysmë kanun i nxjerr nga Qeveria e Përkohshme e Ismail Qemalit në Vlorë me datën 23 maj 1913. Po e quaj gjysmë ligj e gjysmë kanun sepse fajet i klasifikonte në dëme (kundervajtje), krime të vështira (vrasjet) dhe krime të shëmtuara të cilat nuk dënoheshin në bazë të këtij ligji. Përderisa kundervajtjet dhe krimet e vështira gjykoreshin nga gjykata, veprat e shëmtuara dënoheshin sipas të drejtës zakonore.¹³¹ Kjo mënyrë e zgjidhjes së problemeve, ndoshta duhet kuptuar nga fakti se shteti shqiptar ishte në themelim e sipër dhe se krahas faktorëve të jashtëm destabilizues, ai vuante edhe nga mungesa e përkrahjes së gjithëmbarëshme nga shoqëria shqipëtare e cila ende nuk ishte shkëput nga influenca e Stambollit.

Në përkrahje të Qeverisë së Vlorës, me datën 6 shtator 1913, dalin krutanët të cilët në kuvendin e tyre në Krujë kishin kërkuar nga kjo qeveri të zgjidhë një „komisie” për zgjidhjen e gjakmarrjes¹³².

Me që lufta e parë ishte në zhvillim e sipër, dhe zhvillohej në hapsirën gjeografike shqiptare ku grekërit, serbët, bullgarët dhe malaziasit përpiqeshin të përfitonin në kurriz të shqipëtarëve duke shkaktuar mizori kundër tyre, shkodranët thirrën një Kuvend pajtimi në Shkodër me datën 4 shkurt 1915 ku mes tjerash ishte vendosur rregulla e zhdëmtimit për çeshtjen e gjakmarrjes.¹³³

Ne periudhen njëvjeçare 1919-1920 ishin mbajtur një seri Kuvendesh (Kuvendi i Koplikut të Shkodrës, Kuvendi i Bajrakut të Postribës, Malesisë së Madhe, Besa e Lezhës, Shkodrës si dhe Kongresi i Lushnjes) ku përveq problemeve që ishin

¹³⁰ Desku, CenPajtimet ne Motin e Madh-1990, Faik Konica, Prishtinë 2013, fq. 33-41)

¹³¹ Elezi, Ismet E drejta zakonore e Laberise ne planin krahasues, Libri Universitar, Tiranë 1994, fq. 52).

¹³² Elezi, Ismet Vrasjet per hakmarrje e per gjakmarrje ne Shqiperi, Qendra Shqiptare për të drejtat e Njeriut, Tiranë 2000 fq. 51).

¹³³ Po aty, fq. 51 po aty)

=====

shtruar për zgjidhje ishte kërkuar edhe falja e gjaqeve dhe pajtimi.¹³⁴

Kuvendet e pajtimit pas luftës së parë botërore

Në gusht të vitit 1920, të „Sofra e Pajtimit” në Arras , aty ku rrijnë hijerënda nëntë malet e Dibrës, ishte mbajtur një tubim mbarëpopullor i udhëhequr nga personaliteti namë madh i Dibrës, Elez Isufi. Në këtë tubim kishin marrë pjesë shumë udhëheqës nga zonat e thella të Korabit dhe kishin lidhur besë për të luftuar kundër forcave serbe të cilat ishin në kufi. Në këtë kuvend, përveq tjerash ishte vendosur që, kush do që do hakmerrej pas kësaj Bese do përgjigjej para kuvendit dhe para Elez Isufit drejtëpërdrejtë.¹³⁵

Si duket, mungesa e një funksionimi të mirëfilltë e shtetit shqiptar, here pas here ka sjell në skenën publike autoritete të ndryshme popullore, intelektualë dhe ideology kombëtar. Kështu ka ndodhur edhe në Kuvendin e Kurveleshit të datës 13 gusht 1921, ku ishte kërkuar pajtimi i të gjitha armiqësive, pajtimi i njerëzve që ishin në hasmëri, i cili shihej si kusht i bashkimit të shqipëtarëve dhe forcimit të shtetit shqiptar.

Ne kete Kuvend ishte kërkuar mobilizimi i krahinave të kësaj zone për pajtimin e gjaqeve i cili ishte nje ogur i mire para Kongresit të Lushnjës (24 dhjetor 1922) i cili përveq çështjeve me rendësi politike kishte kërkuar vendosjen e autoritetit shtetëror, aplikimin e ligjeve dhe përjashtimin e aplikimit të së drejtës zakonore në gjykimin e „krimeve të shëmtuara” dhe denimin e tyre para një gjykate e cila vepron në bazë të ligjit „...dhe se çdo gjykim duhej të mbështetej në ligj”.¹³⁶

Në kuptim të kufizimit dhe reformimit të të „drejtës”për realizimin e hakmarrjes, Krahina e Laberise ishte angazhuar në një kuvend që të shqyrtohej dhe bisedohej „...çështja e gjakrave (belave) çështje martesash dhe vdekjesh...”¹³⁷. Ky Kuvend i pajtimit dhe reformimit te disa „zakoneve te liga të Kurveleshit” ishte mbledhur ne fshatin Kuç (28 nentor 1924) nën udhëheqjen e intelektualit Salih Hallkakondi e ku merrnin pjese elita e burrave të fjalës dhe pendës nga krahina e Labërisë dhe krahinave tjera të Shqipërisë Jugore.

Duhet cekur se edhe gjatë periudhës së Mbretit Zog ishin organizuar Kuvende Pajtimi edhe në Mirditë (29 maj 1928) nga nënperfektura e Mirditës ku ishin mbledh 25 krerë të pesë Bajraqeve të saj ku ishte formuar edhe një komision i

¹³⁴ Po aty, fq. 51)

¹³⁵ Po aty, fq. 52)

¹³⁶ Elezi, Ismet E drejta zakonore e Labërisë në planin krahasues, Libri Universitar, Tiranë 1994, fq. 52

¹³⁷ Elezi, Ismet E drejta zakonore...fq. 54

=====

pajtimit.¹³⁸ Një kuvend i tillë pajtimi ishte mbajtur edhe në Kurbin në vitin 1936, ku kishin marr pjesë autoritetet shtetërore dhe kishtarë.¹³⁹

Edhe pas pushtimit fashist të Shqipërisë nga Italia, hakmarrja dhe gjakmarrja ishin tema aktuale dhe se për luftimin e kësaj dukurie edhe gjatë kësaj kohe ishin mbajtur kuvende pajtimi. Me datën 24 qershor 1939, Italia fashiste kishte shpall amnisti për të gjitha veprat penale përfshirë edhe ato të vrasjes, por me 14 korrik ministri i qeverisë shqiptare Maliq Bushati kishte kërkuar një pajtim të gjaqeve. Ky propozim ishte pranuar nga komandanti Italian i garnizonit të Krujës i cili kishte kërkuar që ky propozim të zbatohet në çdo prefekturë e nën-prefekturë. Sipas këtij propozimi, palët në hasmëri shkonin para një komisioni mikst shqiptar e Italian me qellim që të pajtoheshin por ky mision nuk kishte patur sukses sepse hakmarrja nuk ishte ndal, përkundrazi frika e hakmarrjes ishte në rritje. Përpjekje të tilla Pajtimi për hakmarrje ishin organizuar nga pushteti fashist edhe në Prefekturën e Peshkopisë në dhjetor të vitit 1939.¹⁴⁰

Kuvendet Kombëtare gjatë Luftës Nacional Çlirimtare

Në kohën e luftës nacionalçlirimtare, hakmarrja dhe gjakmarrja ishte njeri ndër faktoret që pengonin unifikimin dhe pajtimin kombëtar dhe organizimin e luftës së armatosur kundër fashizmit. Me qellim të eliminimit të dukurisë së hakmarrjes, Konferenca e Pezës (16 shtator 1942) kërkon pajtimin e gjaqeve, posaqërisht kërkon luftimin energjik të vrasjeve nga gjakmarrja.¹⁴¹ Ndërsa në Kuç të Kurveleshit, Këshilli Nacional Çlirimtar (23 janar 1943) nxjerr një Vendim ku kërkohej ndërprerja e hasmërive gjatë periudhës së luftës. Edhe në Vendimet e KNÇ të Qarkut të Gjirokastrës të vitit 1943-1944) kërkohet ndalja e hasmërive. Në këtë kuadër dhe në frymën e masovizimit të luftës nacionalçlirimtare kundër fashizmit janë edhe Vendimet e Këshillave në Dukagjin (1943), Mallkastër , Skrapar dhe Mirëditë (viti 1944). Ndërmarrja e këtyre masave nga Këshillat e Pajtimit dhe përfaqësuesit e Bajraqeve kishin arritur ngritjen e vetëdijës kombetare dhe si rezultat i këtij mobilizimi gjithëpopullor, sipas të dhenave të prof. Isemet Elezit ,, ... u arrit që në vitin 1944 të kishte vetëm 7 vrasje për gjakmarrje në të gjithë Shqipërinë”¹⁴²

¹³⁸ Valentini, Giuseppe Studime dhe tekste juridike Plejad Tiranë 2009, fq. 489

¹³⁹ Po aty, fq. 494

¹⁴⁰ Virai, Salvatore Normat zakonore juridike të Shqipërisë Kanuni i Lekë Dukagjinit OMBRA GVG Romë 1940, fq. 74-75, 83

¹⁴¹ Elezi, Ismet Vrasjet per hakmarrje dhe gjakmarrje në Shqipëri, Qendra shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tiranë

2000 fq. 54, 55,

¹⁴² Po aty, fq.54)

Kuvendet Kombetare të shqipëtarëve në ish-Jugosllavi dhe ndikimi i tyre në luftimin e hakmarrjes dhe gjakmarrjes

Në gjysmën tjetër të kombit, në Kosovë dhe vise të tjera në Jugosllavi deri nga fundi i viteve 60 e fillimi i viteve 70 as që bisedohej për iniciativa të tilla. Sipas shënimeve, deri në vitin 1966 kishte të dhëna lidhur me vrasjet e hakmarrjes dhe gjakmarrjes të cilat shënuan një rritje sidomos pas Plenumit të Brioneve (1 korrik 1966). Si rezultat i rritjes së veprave penale të vrasje nga hakmarrja dhe gjakmarrja, kemi Kuvendin e Tuzit i mbajtur në fshatin Tuz të Malit të Zi e njohur si Besëlidhja e Tuzit (28 qershor 1970). Në këtë Kuvend ku merrnin pjesë krerë të Malësisë, krerë nga diaspora dhe nga Kosova i parë nga Anton Cetta ishte vendosur që të kërkohej pajtimi mes familjeve të hasmuara dhe kërkesa për hakmarrje të orientohet vetëm në kryesin e vepres penale të vrasjes, e jo edhe ndaj familjarve të tij.

Po në këtë vit kemi edhe Besëlidhjen e Rugovës e cila është mbajtur në fshatin Drelaj në pranverën e vitit 1970. Në këtë kuvend ishin diskutuar çështja e hakmarrjes dhe gjakmarrjes dhe ishte dhënë Besa sipas së cilës kërkohej të eliminohej vllavrasja dhe të ndalohej hakmarrja. Në këtë kuvend ishte vendosur që çdo mosmarrëveshje duhej të rregullohej nga Këshillat e Pajtimit, dhe se kush nuk respekton vendimet e këtij kuvendi kërkohej që të bojkotimi i familjes së kryesit ndërsa ishte kërkuar që për kryesin e vepres penale të vrasjes të kërkohej denimi me vdekje –pushkatim, përjashtimi i familjes nga Lidhja Socialiste,... Kjo besë vlen për të gjithë Rugovë pa varsisht se ku jetojnë.¹⁴³

Lidhur me problemin e hakmarrjes dhe gjakmarrjes dhe luftimin e kësaj dukurie negative, me datën 1 korrik të vitit 1976, në qytetin e Gjakovës ishte mbajtur Konferenca e XIII e Lidhjes socialiste të Popullit Punonjës ku fjalën kryesore e kishte mbajtur Mahmut Bakalli atëherë kryetar i Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës. Në këtë konferencë ishte kritikuar ashpër aktiviteti i pamjaftueshëm i anëtarëve të gjerë të të gjitha organizatave dhe institucioneve që vepronin jo vetëm në Gjakovë por edhe më gjerë. Në këtë konferencë ishin paraqitur të dhënat statistikore të vrasjeve nga gjakmarrja, burgjet shtëpiake të mbi 1000 familjeve në tërë Kosovën, me rreth 6000 antarë nga të cilët rreth 100-150 veta ishin të ngjuar në burg shtëpiake. Vetëm në Komunën e Gjakovës permenden shifrat e 107 familjeve të hasmuara me rreth 1200 anëtar nga të cilët 42 nxënës të cilët e kishin ndërprerë shkollimin për shkak të frikës nga hakmarrja.¹⁴⁴ Pas një diskutimi të gjërë, nga kjo konferencë, LSPP të Gjakovës kishte dalë me konkluzione prej 21 pikash. Mes tjerash

¹⁴³ Karan Milenko Krvna Osveta, Kultura, Beograd 1985, fq. 61-62

¹⁴⁴ Zurl, Marino Krvna Osveta u Kosovu, August Cesarec Zagreb 1978, fq.274

ishte kërkuar përgjegjësi nga të gjithë komunistët dhe anëtarët e Lidhjes Socialiste. Nga organet e ndjekjes dhe Gjykatat ishte kërkuar ndërmarrja e masav rigoroze me qëllim të parandalimit të saj. Gjithashtu ishte kërkuar ndryshimi në Ligjin Penal dhe ishin propozuar edhe propozime konkrete të cilat lidhen me rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe masen e denimit (kërkohej denimi me burg nga 10 vjet deri në denimin me vdekje). Ndër të tjera në këtë konferencë ishte kërkuar përgjegjësi edhe nga institucionet e ndryshme në përshejtimin e zgjidhjeve të çështjeve administrative dhe civile që lidhen me të drejtat e pronësisë. Mes tjerash ishte kërkuar që në çdo Bashkësi Lokale të formoheshin Këshillat e Pajtimit të cilët do merreshin me trajtimin e problemeve të ndryshme që mund të sjellin deri të hakmarrja.¹⁴⁵

Kuvendet mbarëkombëtare në luftimin e hakmarrjes dhe gjakmarrjes në Kosovë në vitin 1990-1992

Shikuar të kaluarën e zhvillimit ekonomik dhe politik të Kosovës nën sundimin jugosllav (1918-1974), periudha e pas vitit 1974 karakterizohet me një zhvillim epokal në të gjitha sferat. Gjatë sundimit të MSKS-së, Kosova ishte vetëm një emër gjeografik që ekzistonte brenda sovranitetit jugosllav, e privuar nga çdo program zhvillimi. Në aspektin ekonomik, në Kosovë mbretëronte një gjendje e mjerueshme ekonomike e sociale. Derisa në Kosovë brenda periudhës 1918-1941 funksiononin vetëm minierat e Trepçës dhe Novobërdës, në viset e tjera të mbretërisë së SKS-së, industrializimi i vendit kishte shënuar hapa gjigantë. Vetëm “Nga viti 1918-1938 ishin ndërtuar 403 fabrika në Slloveni, 635 në Kroaci dhe Sllavoni, 97 në Dalmaci, 129 në BeH, 390 në Vojvodinë, 428 në Serbi, 99 në Maqedoni dhe 12 në Mal të Zi”. Në aspektin arsimor, shqiptarët në ish Jugosllavi ishin pothuaj jashtë sistemit arsimor sepse “Në tërë periudhën mes dy luftrave botërore në fakultetet jugosllave kanë diplomuar gjithsejt 11 shqiptar”.¹⁴⁶

Pas themelimit të Universitetit të Kosovës në Prishtinë (1970) dhe pas avansimit kushtetues juridik të vitit 1974, Kosova pati një zhvillim të gjithanshëm ekonomik, politik dhe edukativ arsimor. U hap Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, e shumë institucione tjera shkencore e edukative. Në Universitetin e Prishtinës në vitin akademik 1977/1978 studionin 40.820 student në 8 fakultete, një akademi arti dhe 9 shkolla të larta, (faqe 313) me 5.414 profesor Universitar, 15.782 mësues e arsimtar (faqe 308) e 27.018 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme (viti

¹⁴⁵ Po aty, fq. 241-291)

¹⁴⁶ Petranovic, Branko, Istorija Jugoslavije 1918-1988 Prva Knjiga Kraljevina Jugoslavija 1914—1941 Nolit-

Beograd, Fq. 69, 327 http://www.znaci.net/00001/93_10.pdf 26.10.2016).

=====

shkollor 1976/77, faqe 307) dhe 140.648 puntorë të punësuar në sektor të ndryshëm privat e shoqëror ishin perspektiva më e mirë për Kosovën e shekullit të ri.¹⁴⁷ Shkollimi i madh i shqiptarve ishte kthyer në makth për pushtetin serb dhe proserb në Jugosllavi të cilët këtë dukuri e shihnin me defetizëm duke shtuar frikën në opinionin publik se „ Disa prej këtyre intelektualëve të papunësuar, mund të shëndrrohen në vatër të nacionalizmit dhe destabilizimit të Kosovës”. Pas demonstratave të vitit 1981, shovinizmi serb kishte shkuar aq larg sa shkollimin e rinisë shqiptare të Kosovës e cilësonte si ngarkesë të zhvillimit ekonomik e shoqëror duke marrë pretekst diferencën e madhe në mes numrit të studentëve dhe të punësuarve në Kosovë (178.000 të punësuar e 51.000 studentë).¹⁴⁸ Muaji mars-prill 1981 shënon periudhën më të rëndë të Kosovës që nga rënja e Rankoviqit (1966) sepse në Kosovë ishte vendosur gjendja e jashtëzakonshme (2 prill 1981). Kjo periudhë shënon edhe nismën e shformimit të Jugosllavisë së vitit 1974 bazuar në vendimet e gabuara të nxjerrura nga forumet më të larta shtetërore dhe politike në Kosovë, Serbi dhe në federatën Jugosllave.¹⁴⁹ Pas dorëheqjes së Mahmut Bakallit, njëri nga udhëheqësit kryesor në Kosovë, me datën 5 maj 1981, udhëheqja kosovare dorëzohet para presionit serb e jugosllav, ndërsa udhëheqja shtetërore dhe partiake e Serbisë, me obstrukcionet e saj rifillon burgosjet, ndjekjet, persekutimet e rinisë studentëve, intelektualëve, fillon me diferencimet politike e deri te rikonfigurimi i forcave në nivel republikan, krahinor dhe federativ për ndryshime kushtetuese. Kjo periudhë terrori vazhdon deri në vitin 1989, kur Millosheviqi ishte shëndrruar në njeriun më të fuqishëm në ish Jugosllavi rreth të cilit ishin koncentruar gjithë stafi politik dhe ushtarak serb dhe proserb.

Me datën 3 mars 1989 në Kosovë shpallet gjendja e jashtëzakonshme, me 23 mars 1989 Serbia hyn ushtarakisht në Kosovë, me 28 mars 1989. Rinia studenteske dhe popullsia e Kosovës iu kundërvu këtij akti përmes demonstratave massive ane kend Kosovës ku si pasojë e dhunës policore dhe ushtarake vriten 22 dhe plagosen me qindra demonstrues,¹⁵⁰ arrestohen mbi 300 intelektual, drejtor ndermarrjesh, profesor, akademik, të cilët dërgohen në izolim në burgjet e Serbisë. I gjithë ky terror i Millosheviqit kundër shqipëtarëve ushtrohej nga njesitë speciale serbe të ndihmuara edhe nga forca speciale nga republikat tjera (združeni odredi) të cilat drejtoheshin nga Sekretari (ministri) i Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme të Jugosllavisë

¹⁴⁷ Vjetari statistikor i KSAK-ut 1978, Prishtinë fq. 51, 307, 313).

¹⁴⁸ Šta se dogadja na Kosovu, Posebno izdanje Politika Beograd maj 1981, fq.68

¹⁴⁹ Po aty, fq. 20)

¹⁵⁰ Biserko, Sonja Hronologija dogadjaja (1966-2006, Beograd fq.166 <http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Hronologija%20dogadjaja%201966-2006.pdf> parë me datën 10.02.2017

=====

Rezistenca gjithëpopullore kosovare paralajmeronte praneverë të nxehtë përballë terrorit shtetëror serbo jugosllav. Në zgafellat e Trepçës ishin ngujuar minatorët e saj të cilët kërkonin ndryshime politike dhe pajtim gjithëkombëtar duke përfshirë edhe pajtimin e gjaqeve dhe ngatresave mbrenda shqiptare.¹⁵¹ Si rezultat i kësaj iniciative, disa të rinj të rrethit të Pejës ishin mbledhë në shtëpinë e Adem Grabovcit në fshatin Saradran dhe e shfaqin publikisht këtë iniciativë me motivacion se duhet të falen 32 gjaqe në emër të 32 demonstruesve të vrarë nga forcat serbe. Këtë iniciativë ia kishin përcjellë profesorëve Zekirja Canës dhe Anton Çettës në Institutin Albanologjik në Prishtinë të cilët e kishin aprovuar atë ide dhe në krye të „karvanit të pajtimit” bashkë me shumë intelektualë tjerë ishte zgjedh Kryeplaku i Kosovës, zemërbardhi flokëbardhë, i madhi Anton Çetta.¹⁵² Ky mision pajtimi fillon me datën 2 shkurt 1990 në një familje në fshatin Lumbardh të Deçanit, e cila i kishte pranuar „Krushqit e Pajtimit” por nuk ua kishte fal gjakun e djalit të tyre. Edhe pse përpjekja e parë e këtij misioni kishte pësuar mos sukses, ata nuk u ndalën, nuk u dekurajuan, filluan më me përkushtim, dhe përkundër pengesave policore serbe, mbrenda dy vitesh, u pajtuan mijëra familje shqiptare. Sipas studiusit Behram Hoti kjo levizje kishte shtrirje të gjërë dhe përfshinte tërë hapsirën gjeografike shqiptare në ish Jugosllavi dhe se ne të ishin të involvuar akademikët, profesorët, sudentët, gazetarët, pleq të urtë, udhëheqësit fetar (priftërinj, hoxhallarë shehlerë e dervishlerë) të cilët kishin krijuar Keshillat e Pajtimit në nivel qendror dhe lokal,¹⁵³ në ish Jugosllavi dhe në botën perendimore dhe në SHBA.¹⁵⁴ Aktivistët e saj të ndihmuar herë herë edhe nga profesor Antoni dhe ndihmës të tij kanë arritur të pajtojnë shumë familje të cilat ishin në hasmëri të cilat kanë jetuar në këto shtete. Këtë lëvizje për pajtim e ka përkrahur dhe përshendetur edhe Nënë Tereza përmes don Lush Gjergjit¹⁵⁵ e cila në tetor të vitit 1990 përmes letres që i dërgon Ipeshkvit të Kosovës Imzot Nikë Prelës pershendet popullin e Kosovës duke shprehë dëshirat e saj për këtë mision „deshiroj të festojmë se bashku pajtimin e mbarë popullit të shqiptar. Zoti kjoftë me ju dhe dashnija dhe paqja e zoti gjithmonë kjoftë me ju. Zoti Ju bekoftë M.Tereza”¹⁵⁶

Nga bilanci i Lëvizjes Gjithëpopullore Shqiptare për Faljen e Gjaqeve , të plagëve dhe ngatresave kjo lëvizje, nga data 2 shkurt 1990-17 maj 1992 ka arritur të pajtojë 1230 gjaqe, 542 plagë dhe 1180 ngatresave ose gjithsej 2952 pajtime në tere

¹⁵¹ Desku, Cen Pajtimet në Motin e Madh 1990, Faik Konica, Prishtinë 2015 fq.18

¹⁵² Hoti, Behram Moti i madh i kosoves 1990 Pajtimi i Gjaqeve, Faik Konica Prishtinë 2012 fq. 53

¹⁵³ Po aty, fq. 58-74

¹⁵⁴ Po aty, fq. 113-114

¹⁵⁵ Desku, Cen Pajtimet në motin e madh 1990, Faik Konica Prishtinë 2015 fq.105-106

¹⁵⁶ Po aty, fq. 144

=====

haptirën shqiptare ne ish Jugosllavi (Kosovë, Plavë e Guci, në Maqedoni dhe Kosovën lindore (Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë)¹⁵⁷

Kjo levizje për pajtim është konsideruar e përfunduar zyrtarisht në Kuvendin e Tretë të datës 17 maj 1992 me një porosi „...të gjithë shqiptarët të përbuzin me urrejtje institucionin mesjetar të drejtësisë popullore patriarkale-hakmarrjen dhe gjakmarrjen.” Dhe duke e përkujtuar edhe njëherë këtë mision, i përgëzojmë me një urate për gjithë kontributin e dhënë në pajtimin e njerëzve në Kosovë kur thika millosheviqiane ishte vendur në qafën e shqiptarëve jo vetëm në Kosovë por kudo në ish Jugosllavinë e dikurshme: „Qofshin faqebardhë, brez pas brezi, ata Burra e ato Burrerresha që falen gjakun e me të shtrenjtëve, për kauzën tonë kombëtare...!”¹⁵⁸

Përfundime

Fatëkeqësisht, shqipëtarët janë njëri ndër popujt më të vjetër të këtij gadishulli i cili me shekuj nuk ka reshtur së kërkuari lirinë dhe pavarësinë e tij. Ndoshta pozita gjeografike dhe e kaluara e tij historike mijëvjeçare i kanë determinuar një fat të tillë. I gjendur në mes të lindjes dhe përendimit, nëmes të islamit dhe krishtenizmit, nëmes të keqes dhe së mirës, ai u godit nga dallgë të ndryshme të së keqës por qendroj i palëkundur në traditën dhe kulturën e tij, në trojet e tija shekullore (edhe pse të tkurrur) si një shkëmb i pa mposhtur. Fatëkeqësisht, historia ishte e pamëshirshme ndaj tij dhe fatëkeqësisht iu dashtë mund e gjak deri sa realizoj të drejtën e tij për të jetuar i lirë në trojet e tyre, në shtetin e tyre të pavarur (1912). Mungesa e një shteti dhe pushteti kombëtar dhe prezenca e një shteti okupues dhe një pushteti të huaj, i detyroj ata të refuzojnë ligjet e huaja dhe të respektojnë traditat dhe zakonet e të parëve të tyre të cilat ishin të bazuara në Kanunet shqipëtare siç ishte Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skenderbeut dhe Kanuni i Labërisë e mbese edhe ndonjë tjetër më pak i rëndësishëm apo i karakterit lokal. Përkundër asaj se këto kanune nuk janë nxjerrë nga ndonjë organ ligjvënës, ato Kanune janë nxjerrë nga populli dhe janë respektuar po nga populli pavaërsisht ndrrimeve të pushtuesve dhe pushteteve deri në ditët e sotme. Emruesi i perbashkët këtyre normave të së drejtës zakonore shqiptare ishte mbrojtja e jetës dhe trupit, pronës, nderit dhe autoritetit pavarësisht se aplikimi i këtyre normave në shekullin që po jetojmë është jashtë kohe, i pa arsyeshëm, i panevojshëm dhe i dëmshëm. Është e vërtetë se aplikimi i këtyre normave kanunore,

¹⁵⁷ Hoti Behram Moti i madh i Kosovës Pajtimi i gjaqeve, Faik Konica, Prishtinë 2012 fq. 183-185

¹⁵⁸ Pirraku, Muhamet Lëvizja Gjithpopullore Shqiptare për faljen e Gjaqeve 1990-1992, Kronikë, Prishtinë prill 1989 fq 472

=====

shpesh herë ka shkaktuar probleme të mëdha në përpjekjet për çlirim dhe bashkim kombëtar. Megjithatë, burrat e Kanunit anë e kënd viseve shqiptare, në situata të caktuara politike, kanë dijtë t'i vendosin interesat kombëtare mbi interesat individuale dhe kështu kanë lindur Kuvendet Kombetare ku për hirë të atëdheut janë „amnistuar” edhe kryesit e vrasjeve, janë falur gjaqet, dhe ka pushuar pushka e hakmarrjes. Kuvendet e tilla, duke filluar nga Kuvendi i Lezhës e deri te Kuvendet mbarëkombëtare në Kosovë në vitin 1990, kanë qenë zëdhënësit e lirisë, unitetit dhe bashkimit të kombit kundër padrejtësive dhe djallëzive të pushtuesve të ndryshëm të cilët përmes gjakmarrjes dhe hakmarrjes shihnin mundësinë eliminimit të kombit shqipëtar nga këto hapësira. Iniciativat që janë ndërmarr në këto Kuvende, historikisht kanë qenë produktive, kanë forcuar ndjenjën vëllazërore të cilat kanë ndikuar në zbutjen e gjakmarrjes dhe hakmarrjes dhe krijimin e unitetit kombëtar të cilat kanë filluar në fillim të shekullit të XX-të (Pavarsia e Shqipërisë) dhe ka përfunduar në dekadën e parë të shekullit XXI (Pavarsia e Kosovës).

Përkundër asaj se sot kemi dy shtete kombëtare, përkundër asaj se kemi një demokraci të konsoliduar dhe një pushtet kombëtar, hakmarrja dhe gjakmarrja ende po frymon në mjediset tona. Frika nga fenomeni vetgjiqësisë gjegjësisht i hakmarrjes ende ekziston. Andaj, duhet kerkuar institucionet shtetore për zbatimin e ligjit të jenë në krye të detyrës, sepse Kanuni ia ka lëshuar vendin ligjeve të vendit, pleqësia dhe pleqnarët ia kanë lëshuar vendin Gjykatës dhe gjyqtarëve dhe se kërkesa për vetgjiqësi dhe hakmarrje duhet zavendsuar me respektimin e verdiktit të nxjerr nga ana e gjykatës. Sot, në hapsirën gjithëshqiptare po fryejnë erëra demokratike ku shqiptarët janë në tokat e tyre dhe në shtetet e tyre (në Shqipëri dhe në Kosovë) mbisundon rendi dhe ligji edhe pse jo në nivelin e duhur, por kjo po shkon në drejtimin e duhur. Përveq angazhimit të institucioneve shtetërore, gjykatës, prokurorisë dhe policisë, në „luftë” kundër fenomenit të hakmarrjes, si relik i së kaluarës duhet të angazhohet si alternativë e pazavedsueshme, rinia, intelektualët, njerëzit me autoritet dhe prijësit fetarë. Në këtë drejtim secili duhet të angazhohet çdo çast, çdo ditë, çdo javë, çdo muaj e çdo vit sepse kërkesat e këtij vendi, këtij populli janë të përditshme dhe kemi obligim moral dhe kombëtar që t'i dalim përkrah.

Literatura

- Biserko, Sonja Hronologija dogadjaja (1966-2006) Beograd 2006
- Petranovic, Branko, Istorija Jugoslavije 1918-1988 Prva Knjiga, Kraljevina Jugoslavija 1914 —1941 Nolit, Beograd, 1988
- Desku, Cen Pajtimet ne Motin e Madh 1990, Faik Konica Prishtinë 2015

- =====
- Elezi, Ismet E drejta zakonore e Labërise në planin krahasues, Libri Universitar Tiranë 1994
 - Elezi, Ismet Kanuni i Labërisë, Toena Tiranë 2006
 - Elezi, Ismet Vrasjet për hakmarrje e për gjakmarrje në Shqipëri, Qendra shqiptare për të drejtat e njeriut, Tiranë 2000
 - Gjeqovi, Shtjefen Kanuni i Lek Dukagjinit, (ribotim) Kuvendi, Shkodër 2015
 - Historia e Popullit Shqiptar II, ASHSH, Instituti i Historisë, Toena Tiranë 2002
 - Hoti, Behram Moti i madh i Kosoves 1990, Faik Konica Prishtinë 2012
 - Karan, Milenko Krvna Osveta, Kultura Beograd 1985
 - Pirraku, Muhamet Lëvizja Gjithëpopullore Shqiptare për Faljen e Gjaqeve 1990-1992, Kronikë, Prishtinë 1998
 - Rrahimi, Shukri Vilajeti i Kosovës me 1878-1912, Enti i teksteve dhe i mjeteve Rilindja Prishtinë 1969
 - Šta se dogadja na Kosovu, Politika, Beograd, maj 1981
 - Valentini Guissepe (Zef) Studime dhe tekste juridike, Plejad Tiranë 2009
 - Vilari, Salvatore Normat Zakonore Juridike të Shqiperise Kanuni i Lekë Dukagjinit, Romë 1940, OMBRA GVG, 2012 përktheu Qemajl Velija
 - Zurl, Marino Krvna Osveta u Kosovu, August Cesarec, Zagreb 1978

 - http://www.helsinki.org.rs/serbian/doc/Hronologija_dogadjaja_201966-2006.pdf parë me datën 10.02.2017
 - 327 http://www.znaci.net/00001/93_10.pdf 26.10.2016